



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli: Ferrero International S.A / Fannie May Confections Brands Inc.

Në datën 31 Mars 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Marrëveshjes së blerjes së aksioneve”. Me anë të kësaj marrëveshje, të nënshkruar me datë 15 Mars 2017, synohet të realizohet kalimi i plotë i kontrollit të shoqërisë Fannie May Confections Brands Inc. (“Target”) nga shoqëria 1-800-Flowers.com Inc. (“Shitësi”) tek shoqëria Ferrero International S.A (“Blerësi”).

Ky njoftim bëhet për shkak se Blerësi Ferrero International S.A realizon shitje në Shqipëri nëpërmjet dy distributorëve të tij dhe plotësohen kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Ferrero International S.A:** është një shoqëri prodhuese e produkteve ushqimore i cili ushtron aktivitet në prodhimin dhe tregtimin e ëmbëlsirave dhe produkteve të tjera të ëmbla.
- **Fannie May Confections Brands Inc.:** është e përfshirë në aktivitetin e prodhimit , reklamimin, shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të paketuara çokollate në SHBA.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me neni 10, pika 1, shkronja b dhe c, dhe neni 12, pika 1 dhe 2 , të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al